



**AKT-THEMELIMI  
PER SHOQERINE TREGETARE**

**“VASPORT” SH.P.K.**

Ortaku I vetem : Z.Aurel CYFEKU I biri I Jonelit ,datelindja 06.08.1976lindur dhe banues ne Korce, me numer pashaporte 1862491, ne baze te Ligjeve te kuvendit te Republikes se Shqiperise nr.7512 date 10.8.1991, Ligjit nr. 7638 date 19.12.1992 dhe Ligjit 7764 date 2.2.1993:

**VENDOSI**

**NENI 1**

Te themelojne nje shoqeri tregtare per te zhvilluar veprimtari private si person juridik te emeruar:

**“VASPORT”**

**(SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR)**

Shoqeria do te kete seline e saj ne qytetin e Korces, Bulevard 'Republika', Korce.

**NENI 2**

Ne perputhje me legjislacionin shqiptar shoqeria eshte person juridik. Veprimtaria e saj do te rregullohet sipas dispozitave te ketij akti themelimi, statut si dhe ligjeve shqiptare ne fuqi.

Statuti I shoqerise I bashkangjitet ketij akti themelimi dhe eshte pjese perberese e saj.

Shoqeria pergjigjet vete me pasurine e saj per te gjitha detyrimet qe lindin nga aktiviteti I saj.

Ortaku I vetem pergjigjet per detyrimet e shoqerise dhe I perballon vete ato.

Shoqeria nuk pergjigjet me detyrime te tjera ndaj shtetit Shqiptar pervec atyre te parashikuara shprehimisht ne ligj dhe anasjelltas.

### NENI 3

#### OBJEKTI I SHOQERISE

Objekti I veprimtarise se shoqerise tregetare "VASPORT" Sh.P.K. zhvillohet ne keto drejtime:

- Tregetim te artikujve te ndryshem industriale, kinkaleri, konfeksione, me shumice e pakice, import-eksport.
- Tregetim te artikujve te ndryshem plastike, kimike, elektrike, inerte, me shumice e pakice, import -eksport.
- Tregetim te artikujve te ndryshem, lende ndertimi, prodhimeve metalike, dyer, dritare, duralumine etj, me shumice e pakice, import-eksport.
- Tregetim te artikujve te ndryshem ushqimore, fruta-perime, pije te ndryshme, me shumice e pakice, import -eksport.

Transport I artikujve te ndryshem ushqimore, fruta-perime, pije te ndryshme etj.

Transport I artikujve te ndryshem Industriale, kinkaleri, konfeksione, materialeve plastike, kimike, inerte.

Transport I artikujve te ndryshem, si lende ndertimi, prodhimeve metalike, dyer, dritare, duralumine etj.

Transport udhetaresh brenda dhe jashte vendit.

Keto veprimtari synojne arritjen e objektivave te lartpermendura duke respektuar dhe ne perputhje me programet e veprimtarise ekonomike financiare te parashikuar nga ortaku I vetem.

Shoqeria ka te drejte te zgjeroje aktivitetin e saj dhe ne drejtime te tjera ne perputhje me vendimet e marra nga ortaku I vetem.

### NENI 4

Kohe zgjatja e kesaj shoqerise do te jete deri ne 10 vjet, me mundesine e zgjatjes ose shkurtimin e ortakut te vetem.

### NENI 5

Kapitali themeltar I shoqerise eshte 100.000 lek I depozituar nga ortaku I vetem. Kapitali themeltar do te perbehet dhe nga mjetet e nevojshme monetare si dhe mjetet e tjera te nevojshme materiale te cilat do te duhen per funksionimin normal te shoqerise.





## NENI 6

Ortaku I kesaj shoqerie ka te drejte te ndryshoje kapitalin themeltar ne perputhje me ligjin ose dhe ta transferoje ate tek persona te trete, bashkeshorte ose trashegimtare te tyre sipas dispozitave perkatese te kodit civil.

## NENI 7

Organi drejtues I shoqerise eshte asambleja, e cila perbehet nga ortaku I vetem. Administrator I kesaj shoqerie eshte Z.Aurel CYFEKU.

## NENI 8

Shoqeria fillon veprimtarine e saj ne daten e rregjistrimit ne gjykatën e shkalles se pare Tirane dhe ne zyren e taksa tatimeve te caktuar nga Ministria e Financave (zyra e taksa tatimeve Korce) ku eshte edhe selia e saj.

## NENI 9

Fitimi neto I shoqerise del mbasi zbriten shumat qe I perkasin detyrimeve ligjore dhe fondet rezerve ne perputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar. Fitimi dhe shperblimet e tjera mund te transferohen lirisht jashte shtetit me valute te konvertueshme me llogarine rrjedhese te shoqerise.

## NENI 10

E gjithë veprimtaria e shoqerise dhe investimet e saj mbrohen nga shteti I cili I garanton shoqerise trajtimin e tij.

## NENI 11

Shoqeria per te kryer punen dhe aktivitetin e saj normal mund te punesoje persona te trete te cilet kane per detyrim te ruajne sekretin e punes dhe veprimtarise konkrete te shoqerise.



**NENI 12**

Te gjitha mosmareveshjet qe mund te lindin gjate aktivitetit te kesaj shoqerie, me personat e punesuar ne te ose me persona te trete do te zgjidhen sipas dispozitave te Kodit Civil shqiptar ne fuqi ne gjykaten e rrethit ku ka seline shoqeria, ne rastin konkret gjykata e shkalles se pare Korce.

**NENI 13**

Per te gjitha ato ceshtje qe nuk jane shenuar ne kete akt themelimi dhe statutin e shoqerise, do te zbatohen dispozitat e Kodit Civil Shqiptar ne fuqi dhe normat e tjera ligjore te parashikuara ne legjislacionin e Republikes se Shqiperise.

Ky akt themelimi pasi u lexua prej ortakut te vetem nenshkruhet rregullisht prej tij.

**ORTAKU I VETEM**  
**Aurel CYFEKU**



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**DHOMA E NOTERISE KORCE**  
**NOTER PUBLIK**  
**NE--PROT--**


071 975

**VETETIM NENSHKRIMI**

Sot ne daten 19.2.2004 ne zyren e noterise Korce, para meje notere F. B. B. B.  
u paraqit personalisht: Z.Aurel CYFEKU, I biri I Jonelit, datelindja 06.08.1976 lindur dhe banues ne Korce, I pa njohur prej meje per identitetin e te cilit u njoha nepermjet pasaportes me nr.1862491, madhor, I afte per te kryer veprimis juridike, I cili deklaroi se nenshkrimi I vene ne kete akt themelimi eshte I tij.



**Notere**



# STATUT

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“VASPORT” SH.P.K  
KORCE



Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar “VASPORT” Sh.P.K. eshte themeluar nga: ortakut I vetem AUREL CYFEKU ne baze te aktit te themelimit te nenshtruar nga ortakut I vetem, ne perputhje me ligjet e Kuvendit Popullor te Republikes se Shqiperise nr.751 date 10.8.1991, Ligjit nr.7632 date 4.11.1992, Ligjit nr.7638 date 19.12.1992 dhe ligjit 7764 date 2.2.1993.

### DISPOZITA TE PERGJITHSHME

#### NENI 1

Shoqeria eshte person juridik i se drejtes shqiptare dhe gezon te drejtat e personit juridik nga data e rregjistrimit ne rregjistrin tregetar. Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje te plote me legjislacionin shqiptar dhe dispozitat e aktit te themelimit te ketij statuti.

### OBJEKTI I VEPRIMTARISE

#### NENI 2

Objekti i veprimtarise se shoqerise zhvillohet ne ato fusha qe jane permendur ne aktin e themelimit si me poshte:

Tregetim te artikujve te ndryshem industriale, kinkaleri, konfeksione, me shumice e pakice, import-eksport.

Tregetim te artikujve te ndryshem plastike, kimike, elektrike, inerte, me shumice e pakice, import –eksport.

Tregetim te artikujve te ndryshem, lende ndertimi, prodhimeve metalike, dyer, dritare, duralumine etj, me shumice e pakice, import-eksport.

Tregetim te artikujve te ndryshem ushqimore, fruta-perime, pije te ndryshme, me shumice e pakice, import –eksport.

Transport I artikujve te ndryshem ushqimore, fruta-perime, pije te ndryshme etj.

Transport I artikujve te ndryshem Industriale, kinkaleri, konfeksione, materialeve plastike, kimike, inerte.

Transport I artikujve te ndryshem, si lende ndertimi, prodhimeve metalike, dyer, dritare, duralumine etj.

Transport udhetaresh brenda dhe jashte vendit.



## SELIA E SHOQERISE

### NENI 3

Shoqeria me prjegjesi te kufizuar "VASPORT" Sh.P.K. ka qendren e saj legale ne Korce, Bulevard 'Republika', Shqiperi.

Shoqeria mund te kryeje e te transferoje, apo te suprimoje qendra administrative, seli filiale, agjensi dhe zyra ne teritorin e republikes dhe jashte vendit.

### KOHE ZGJATJA

### NENI 4

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise "VASPORT" SH.P.K eshte deri ne 10 vjet Ortaku I vetem mund te vendose zgjatjen e ketij afati ose zgjidhjen e parakohshme te shoqerise.

### DETYRIMET E ORTAKEVE

### NENI 5

Ortaku I vetem duhet te kryeje depozitimimin e kapitalit themeltar per llogari te shoqerise ne forme te nje note rose ne forme cash ne nje banke.

### TRANSFERIMI I KUOTAVE

### NENI 6

Ortaku I vetem mund te kaloje pjese nga kapitali themeltar ne persona te tjere ne perputhje me rregullat e parashikuara ne Ligjin 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerine Tregtare".



## PARAQITJA KONTABILE

### NENI 7

Operacionet e shoqerise kontabilizohen duke aplikuar parimet e kontabilitetit te parashikuara ne legjislacionin shqiptar dhe paraqitjen me saktesi ne bilancin vjetor te aktivitetit.

Ne mbyllje te cdo viti ortakut I vetem ose personi I ngarkuar prej tij, ben inventarizimin dhe llogarite vjetore ne perputhje me dispozitat e legjislacionit ne fuqi per kontabilitetin dhe harton raport me shkrim. Ky raport pasqyron gjendjen e shoqerise gjate vitit financiar.

## KAPITALI THEMELTAR

### NENI 8

Kapitali themeltar I shoqerise eshte 100.000 lek dhe ndahet ne pjese te barabarta, vlera normale e te cilave nuk mund te jete me e vogel se 1.000 lek.

## OPERACIONET FINANCIARE

### NENI 9

Shoqeria eshte e autorizuar per te siguruar mjete financiare dhe kredit duke ju drejtuar bankave, institucioneve te kreditit ose atyre te financimeve totale apo te jashtme, institucioneve nderkombetare te financimit dhe te kreditit sido qe te jete percaktuar.

## BLERJET E SHOQERISE

### NENI 10

Shoqeria disponon me mjetet e saj ne perputhje me destinacionin e tyre dhe me objektin e shoqerise. Shoqeria mund te bleje dhe te administroje mallrat e cfaredo lloji dhe natyre ne funksion te aktivitetit te saj legal si dhe mund te jape mallrat e saj me garanci per te are kredi nga Banka ose institucione krediti.

Ne Republiken e Shqiperise, shoqeria gezon te drejten e saj per te zoteruar mjetet e saj si cdo shoqeri tjeter ose organizate tregtare, kombetare shqiptare ne perputhje me Ligjin nr.7496 date 4.8.1991 si dhe ligjin nr.7638 date 19.11.1991 "Per shoqerine tregtare".





## FONDET REZERVE

### NENI 11

Shoqeria mund te themeloje nje fond rezerve si dhe fonde te tjera te vecanta per zhvillimin e tij.

Perberja, shuma totale, fondet per krijimin e tyre, perdorimi dhe rregullimi i tyre (i cdo fondi) percaktohet nga ortaku i vetem ne perputhje me legjislacionin shqiptar. Vlerat materiale te shoqerise raportohen ne balance te shprehura ne lek shqiptare, ne perputhje me rregullat ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

Bilanci dhe perlllogaritjet ekonomike te shoqerise hartohen mbi bazen e formes se bilancit dhe llogaritjeve ekonomike te percaktuara per shoqerite tregetare ne Shqiperi. Bilancet vjetore mbylleten ne 31 Dhjetor te cdo viti.

## PLANET FINANCIARE

### NENI 12

Aktiviteti i shoqerise realizohet mbi bazen e programeve financiare qe bejne pjese ne aktivitetin tregetar te saj.

Planet financiare parashikojne koston dhe te ardhurat e shprehura ne lek shqiptare.

Gjendja pasurore dhe llogaritjet ekonomike do te paraqiten ne lek shqiptare.

Rezultatet financiare te aktivitetit dhe te punes se kryer nga shoqeria, paraqiten ne bilancin vjetor.

Kursi i kembimit te monedhes shqiptare me monedhat e huaja dhe te kunderta do te jene ato te vendosura nga Banka e Shtetit Shqiptar.

## DREJTIMI I SHOQERISE

### NENI 13

Organ drejtues i shoqerise "VASPORT" Sh.P.K. eshte asambleja e perbere nga ortaku i vetem.





## ORTAKET

### NENI 14

Ortaku I vetem ne pershtatje me nenin 61 te Ligjit 7638 date 19.12.1991 "Per shoqerine tregetare" ne drejtimin e shoqerise te drejtuar prej tij, ka te drejtat qe ky ligj I njej asamblese te ortakeve.

Ortaku I vetem mund ti delegoje kompetencat personave te tjere

## ADMINISTRATORI

### NENI 15

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar administrohet nga nje ose nga disa persona fizike. Administratori emerohet me vendim te ortakut te vetem. Ne rast se ortakut I vetem vendos ndryshe, administratori emerohet per tere periudhen e ekzistences se shoqerise.

Administrator I kesaj shoqerie este ortakut I vetem Z. Aurel Jonel CYFEKU.

Administratori I ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat, me perjashtim te kompetencave qe u njej ligji shprehimisht te treteve.

Administratori ka pergjegjesi ndaj shoqerise ose ndaj te treteve per shkelje te ligjeve, statutit apo shkeljeve te kryera gjate administrimit.

Administratori ne rastin konkret kryen dhe harton raportet financiare, llogarite vjetore etj.

## RAPORTET E PUNES

### NENI 16

Raportet e punes ndermjet shoqerise, filialeve dhe agjensive te saj si dhe te punonjesve te punesuar ne te , rregullohen ne baze te kontrates se punes, konform kodit te Punes. Pert sa nuk parashikohet ne kontraten e punes, aplikohen dispozitat e legjislacionit shqiptar ne fuqi.



## PERFUNDIMI I AKTIVITETIT

### NENI 17

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar priset:  
Me kalimin e afatit te fiksuar per kohezgjatjen e saj ne kontraten e themelimit.  
Per pamundesine e realizimit te objektit te saj.

## LIKUJDIMI

### NENI 18

Likujdimi I shoqerise me pergjegjesi te kufizuar do te behet sipas normave te legjislacionit shqiptar ne fuqi ne kohen e likujdimit.  
Ortaku I vetem do te percaktoje menytrat e likujdimit te shoqerise dhe do te caktoje nje ose shume likujditatore duke I percaktuar dhe detyrat konkrete.  
Likujditoret kujdesen qe ne rradhe te pare te shlyejne detyrimet qe ka shoqeria ndaj personave te trete. Per sa nuk eshte shprehur plotesisht dhe saktesisht ne kete statut do t'I referohen plotesimeve qe mund te beje ortaku I vetem si dhe ligjeve te vecanta te legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Ky statut firmoset rregullisht.

## ORTAKU I VETEM

Aurel CYFEKU

